



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

URDHËR

NR. 06 DATË 24.4.2012

**“PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR.147, DATË 09.05.2008 “PËR UNIFIKIMIN
E USHTRIMIT TË FUNKSIONEVE NË PROKURORITË E SHKALLËS SË
PARË””**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 paragrafi “gj” të ligjit nr.8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar),

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.147 datë 09.05.2008, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, bëhet kjo shtesë:

1. Pas pikës 3, shtohet pika 3.1 me përmbajtjen që vijon:

“3.1 Kontrolli i procedimeve penale, para se drejtuesi i prokurorisë të shprehet për bazueshmërinë në ligj të akteve dhe të procedimit penal, në përputhje me pikën 3 të urdhrin nr.147 datë 09.05.2008, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, bëhet nga zëvendës drejtuesi i cili duhet të japë mendimin e tij, në prokuroritë e shkallës së parë ku ka funksion të tillë” .

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

